

## INFORMACION PËR TË MITURIN NË KONFLIKT ME LIGJIN

---

### *INFORMACION PËR TY QË JE SUBJEKT I NDJEKJES PENALE PËR SHKAK SE JE I DYSHUAR PËR KRYERJEN E NJË VEPRE PENALE*

---

#### LETRA E TË DREJTAVE

**Kjo Letër e të Drejtave rendit dhe shpjegon të drejtat e tua si i mitur i përfshirë në një hetim nga Policia Gjyqësore dhe Prokuroria.**

#### **Ti ke të drejtat e mëposhtme:**

1. Policia Gjyqësore ose Prokurori duhet të të njoftojnë dhe të të tregojnë sa më shpejt:
  - për llojin e veprës penale që dyshojnë se ke kryer,
  - për kohën dhe vendin ku mendojnë se e ke kryer,
  - për arsyen pse mendojnë se e ke kryer veprën penale
  - nëse je i arrestuar ata duhet të të tregojnë arsyen pse je arrestuar dhe
  - për arsyen pse të mbajnë në ambientet e policisë.

Ky informacion duhet të të jepet në një gjuhë që ti e kupton.

2. Nëse nuk flet ose kupton shqip, ke të drejtë për shërbim interpretimi/përkthimi falas në çdo moment që flet ose intervistohesh. Gjithashtu ke të drejtë për të marrësh një kopje të Letrës së të Drejtave në një gjuhë që ti flet ose kupton. Nëse nuk të jepet përkthimi, informacioni duhet të të jepet përmes një interpreti dhe përkthimi, duhet të të jepet sa më shpejt që të jetë e mundur. Policia do të caktojë një interpretues të gjuhës së shenjave për të të ndihmuar, nëse është e nevojshme.
3. Nëse të bëhen pyetje për veprën penale të dyshuar, nuk je i/e detyruar të japësh përgjigje dhe shpjegime.
4. Të ndihmohesh nga një psikolog gjatë gjithë hetimit. Ndaj mos hezito të kërkosh ndihmën e tij/saj në çdo moment të hetimit.
5. Nëse dëshiron, prindërit ose një person tjetër i besuar mund të qëndrojnë me ty gjatë kryerjes së veprimeve hetimore.
6. Të mbrohesh me avokat gjatë gjithë hetimit. Policia dhe prokurori janë detyruar të sigurojnë në çdo rast mbrojtjen me avokat. Avokati e njeh ligjin dhe mund të të ndihmojë dhe të të këshillojë. Shumë njerëz kërkojnë që të flasin me avokatin. Kjo nuk do të thotë që ke bërë ndonjë faj. Mund të marrësh avokat falas, ose nëse dëshiron, mund të zgjedhësh avokatin që e paguan vetë. Fol me policinë ose prokurorin për këtë çështje.

7. Nëse dëshiron mund të flasësh me avokatin ose prindin ose person tjetër që ndodhet aty për të të ndihmuar, në privatësi, pa praninë e policisë ose prokurorit.
8. Të kesh kohën e nevojshme për t' u përgatitur, së bashku me avokatin ose person tjetër që të përfaqëson, përpara intervistimit nga policia.
9. Policia duhet të të shpjegojë provat mbi të cilat ata kanë vendosur të të mbajnë në ambientet e policisë gjatë intervistës (pyetjes) tënde. Nëse çështja shkon në gjykatë, ti ose avokati mund të shihni të gjitha provat, siç janë kopje të deklarimeve të personave që kanë dijeni për ngjarjen dhe detaje të provave të tjera.
10. Nëse dëshiron, mund të paraqesësh me shkrim ose me gojë çdo gjë që ti mendon se mund të të ndihmojë gjatë hetimit.
11. Nëse dëshiron mund të pyesësh dëshmitarët, ekspertët ose të dyshuarit e tjerë të çështjes kur jeni përpara gjykatës.
12. Nëse dëshiron mund të kërkosh ndryshimin e çdo vendimi të marrë gjatë hetimit ose pasi prokurori ose gjykata të ketë marrë një vendim.
13. Emri dhe çdo informacion tjetër për ty të mbahet i fshehtë që të shmanget identifikimi yt nga publiku.
14. Përveç të drejtës për të kontaktuar një avokat për arrestimin tënd, ti ke të drejtë t'i tregosh policisë nëse dëshiron që ndonjë person të dijë vendndodhjen tënde. Nëse nuk ke një person të tillë, kërkoi policisë që të kontaktojë dikë tjetër.
15. Të informohesh për mundësitë që të marrësh pjesë në aktivitete për të riparuar çdo dëm të mundshëm ndaj pronës ose marrëdhënieve personale i cili mund të jetë shkaktuar nga veprimet e tua dhe të kërkosh zbatimin e masave alternative të mundshme.
16. Ti gjithashtu ke të drejta të tjera të shpjeguara në ligj që avokati ose person tjetër i besuar mund të të shpjegojë.

*Unë e mora letrën e të drejtave të të miturit në konflikt me ligjin, sot më datën*

---